



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIC OF KOSOVA



REPUBLIKA KOSOVA
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Datë:	05.09.2023
Referencë:	ZR
Për:	Imri AHMETI, Kryetari Komunës
Nga:	Imri Semetishti, Drejtor i DPUMM
Kopje:	Diamant Bytyçi, Nënkyetar i Komunës Lulzim Qerimi, Nënkyetar i Komunës Avni Jashari, Shef i Kabinetit të Kryetarit të Komunës
Lënda:	RAPORTI MUJOR I PUNËS – Gusht 2023

Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, bazuar në detyrat e përcaktuara sipas Planit Vjetor të Punës për vitin 2023, ju dorëzon:

RAPORTIN MUJOR
TË PUNËS PËR PERIUDHËN RAPORTUESE 01.08.2023-31.08.2023

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periudhës raportuese DPUMM- në sektorin e Urbanizmit ka zhvilluar aktivitetet themelore si vijon:

Gjatë kësaj periudhe DPUMM ka trajtuar disa prej lëndëve të pranuar dhe kerkesave të bartura. Gjatë muajit gusht 2023 janë pranuar gjithsejt 61 kërkesa të natyrave të ndryshme, kurse të bartura kanë qenë gjithsejtë 117 lëndë, që në total rezultojnë të jenë 178 lëndë për shqyrtim. Prej tyre janë trajtuar gjithsejtë 47 kërkesa, 36 të miratuara, 7 të refuzuara, 2 të pezulluara, kurse 2 janë bartur në sektorë të tjerë sipas kompetencës lëndore. Për shqyrtim barten 131 lëndë të natyrave të ndryshme.

Statusi i trajtimit të lëndëve është prezantuar në pjesën tabelare.

Në kuadër të aktiviteteve të tjera DPUMM ka kryer edhe aktivitete të tjera.

Në fushën e planifikimit hapësinor është vazhduar me:

- Procesin e hartimit të PZHK-së, faza e III-të “Korniza e zhvillimit hapësinor”, ku ka vazhduar - zhvillimi i procesit të definimit të Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike.

Në kuadër të aktiviteteve të përgjithshme kemi përfunduar:

- Hartimin e Raportit për monitorimin e zbatimit të Hartës Zonale të Komunës për periudhën një vjeçare 03.07.2022 deri me 03/07.2023.

- Kishte edhe angazhime të veçanta në kuadër të komisioneve të ndryshme, vlerësime të ofertave, pranime teknike, leje mjedisore komunale etj.

- Janë hartuar disa detyra projektuese për hartimin e dokumentacionit teknik sipas kërkesave të drejtorateve përkatëse – Infrastrukturës, Arsimit dhe Kulturës.

- Ka vazhduar procesi për sistemin e adresave. Ky proces teknikisht ka përfunduar në ARIS/SIRA (Sistemi Informativ i Regjistrimit të Adresave).

- Aktivitet i veçantë ishte edhe pjesëmarrja në hartimin e “Hartës dixhitale”.

Aktivitetet themelore për muajin vijues:

- Angazhimet intensive në procesin e hartimit të PZHK-së, faza e III-të “Korniza e Zhvillimit Hapësinor”.

STATISTIKAT

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga palët

Nr.	Llojet e kërkesave	Të pranuar	Nga periudha e kaluar	Të miratura	Të pezulluara	Të refuzuar	Të bartura në sektor të tjerë	Në proces (pritje)
1.	Kushte ndërtimore	11	5	6		1	3	9
2.	Leje ndërtimi	9	10	4	2	3		10
3.	Leje renovimi, apo vendosje e objekteve të përkohshme	11		4				7
3.	Leje rrënimi	3	-			1		2
4.	Certifikatë përdorimi		1					1
5.	Emertim rruge	2	-				2	
	Nr. i shtëpisë /adresa	-	-					
6.	Informacione urbane	6		6				-
8.	Certifikatë legalizimi /Leje Legalizimi	1	90			1		90
9.	Legalizimi/ Në listë të pritjes	2		2				
10.	Kërkesa të tjera	16	11	14		1		12
	Gjithsejt:	61	117	36	2	7	2	131

DISKUTIME PUBLIKE:

Gjatë muajit gusht 2023 nuk kishte diskutime publike.

SFIDAT:

- Numri i lartë i kërkesave të bartura dhe njëkohësisht numri i lartë i kërkesave të pranuar brenda muajit. Ky numër i lëndëve edhe më tutje pamundëson shqyrtimin e kërkesave brenda afateve ligjore.

- Pamundësia e shqyrtimit të kërkesave për trajtimin e objekteve pa leje ndërtimi në mungesë të kapaciteteve. Aktiviteti për angazhimin e dy konsulentëve për këtë proces është në vijim e sipër, pritet të përfundoj brenda disa ditësh.

Buxheti:

Deri në fund të muajit gusht 2023 në kuadër të DPUMM-së janë shpenzuar 125,626.48€ ose 50.25% e buxhetit në kuadër të kategorisë ekonomike “Mallra dhe Shërbime” – të buxhetuara 250,000.00.

Në bazë të të gjitha parashikimeve mjetet e planifikuara për hartimin e projektit për qendren kulturore nuk do të shpenzohen për shkak se ky proces edhe më tutje nuk është zgjidhur nga OSHP, pastaj kësti i fundit për hartimin e PZHK-së pritet të mos paguhet në pamundësi të finalizimit të këtij projekti.